



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 126

Prishtinë, Dt. 16/01/2026

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Projektpropozimi	"Flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë)" / "Vascular flora along the flow of the Mirusha river (Bllacë-Mirushë)"
Kandidati	Agesa Krasniqi
Mentori	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.02.2025 Vendimi nr.: 680

Vlerësimi i dorëshkrimit

Shënimet e përgjithshme

Punimi i Masterit i kandidatës **Agesa Krasniqi** përmban 60 faqe tekst me rrallim normal. Në punim janë 19 figura dhe 3 tabela. Në punim janë cituar 45 burime nga literatura etj. Në tërësinë e tij, punimi përmban **abstrakt** dhe **rezyne** në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. **Autobiografia** e kandidatës gjendet në fund të punimit.

Në përmbajtje punimi ka: **Hyrje** (faqe 14-16), **Qëllimi dhe rëndësia e punimit** (faqe 17), **Të dhëna të përgjithshme për rrjedhën e lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë)** (faqe 18-20), **Aktivitetet dhe ndikimi antropogjen** (faqe 21), **Vështrim i përgjithshëm i florën dhe vegjetacionit në zonën e hulumtuar**

(faqe 22-23), **Materiali dhe metodat e hulumtimit** (faqe 24), **Rezultatet e hulumtimit** (faqe 25-45), **Diskutim** (faqe 46-48), **Përfundime** (faqe 49), **Literatura** (faqe 50-53), **Rezyme** (faqe 54-56), **Summary** (faqe 57-59). **Autobiografia** (faqe 60).

Analiza e Punimit

Në **Hyrje** kandidatja në mënyrë të përgjithësuar përshkruan të dhëna për zonën e hulumtuar, si dhe për florën dhe vegjetacionin e zonës.

Te **“Qëllimi dhe rëndësia e punimit”** jepen arsyetime për qëllimin dhe rëndësinë e hulumtimit.

Në kapitullin **Të dhëna të përgjithshme për rrjedhën e lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë)**, paraqiten në veçanti me ç’rats përshkruhet pozita gjeografike, përbërja pedologjike si dhe kushtet klimatike zonës.

Aktivitetet dhe ndikimi antropogjen trajtohen në pjesë të veçantë.

Në kapitullin **“Vështrim i përgjithshëm i florën dhe vegjetacionit në zonën e hulumtuar”** bazuar në gjendjen faktike në terren paraqiten të dhëna për florën dhe vegjetacionin e zonës së hulumtuar përgjatë rrejdhës së lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë).

Materiali dhe metodat e hulumtimit përshkruhen si pjesë e veçuar dhe përshkruhen detajet e duhura.

Rezultatet e hulumtimit paraqiten në formë tabelare, të detajuara. Grupet kryesore të bimëve janë radhitur sipas filogjenisë, pëdrerisa kategoritë tjera më të ulta sistematike si familjet, gjinitë dhe llojet janë sipas alfabetit.

Përmes tabelave dhe figurave në vijim janë prezantuar **"Format korologjike"** dhe **"Format jetësore"**.

"Fotografi të llojeve bimore" janë origjinale dhe disa prej tyre prezantohen në veçanti.

Diskutim dhe përfundimet gjithashtu paraqiten veçmas duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit.

Literatura e cituar është e kohës dhe përkatëse sa i përket hulumtimeve floristike në përgjithësi por edhe për florën vaskulare në veçanti.




Vlerësimi dhe propozimi

Duke u bazuar në dorëshkrimin e punimit, Komisioni për vlerësim e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit me titull “Flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë)” / “Vascular flora along the flow of the Mirusha river (Bllacë-Mirushë)” të kandidatës Agnesa Krasniqi.

Me këtë rast, komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologjisë si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që ta pranojë propozimin dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit të lartpërmendur, me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit).

Prishtinë, 16.04.2026

Komisioni:

1. 
/ Prof. Dr. Fadil Millaku – kryetar/
2. 
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar (mentor)/
3. 
/ Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.